



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

OPERATORIT EKONOMIK “BNT ELECTRONICS” SH.P.K
ADRESA: TIRANE BULEVARDI ZHAN D'ARK, ND.32, HYRJA16, KATI 2, AP.1..

* * *

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur” (Marrëveshje kuadër) me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

Referenca e procedures: REF-95657-05-17-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Shërbimi i printimit”

Fondi limit: 62.282.781 (gjashtëdhjetë e dy milion e dyqind e tetëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e një) lekë pa tvsh.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutim: 3 (tre) vjet ose 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga data e lidhjes së marrëveshjes/kontratës.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike **Nr. 79 datë 24 Maj 2021.**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë:

1. **I. Bashkimi i operatorëve ekonomik “PC STORE” sh.p.k dhe “RIKON- AL” Sh.p.k**
2. **II. Operatori ekonomik “Sinteza CO” Sh.p.k**

3. **III. Operatori ekonomik “Adenis Kastrati”**
4. **IV. Operatori ekonomik “BNT Electronics” Sh.p.k**

1. Oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “PC STORE” sh.p.k dhe “RIKON- AL” Sh.p.k
NUIS L01606034A dhe NUIS L22119010H

Çmimi total i ofertës pa TVSH= 48.776.028 (dyzet e tetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëzet e tetë) lekë dhe Çmimi total i ofertës me TVSH = 58.531.233,6 (pesëdhjetë e tetë milion e pesëqind e tridhjetë e një mijë e dyqind e tridhjetë e tre presje gjashtë) lekë.

2. Oferta e paraqitur operatori ekonomik “BNT Electronics” sh.p.k NUIS J61817047D

Çmimi total i ofertës pa TVSH= 61.875.986,40 (gjashtëdhjetë e një milion e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë presje dyzet) lekë dhe Çmimi total i ofertës me TVSH = 74.251.183,68 (shtatëdhjetë e katër milion e dyqind e pesëdhjetë e një mijë e njëqind e tetëdhjetë e tre presje gjashtëdhjetë e tetë) lekë.

3. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Sinteza CO” Sh.p.k NUIS K11324003F

Çmimi total i ofertës pa TVSH= 62.232.541,50 (gjashtëdhjetë e dy milion e dyqind e tridhjetë e dy mijë e pesëqind e dyzet e një presje pesëdhjetë) lekë dhe Çmimi total i ofertës me TVSH = 74.679.049,80 (shtatëdhjetë e katër milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyzet e nëntë presje tetëdhjetë) lekë.

4. Oferta e paraqitur nga peratori ekonomik “Adenis Kastrati” NUIS L51611004I

Çmimi total i ofertës pa TVSH= 0 (zero) lekë dhe Çmimi total i ofertës me TVSH = 0 (zero) lekë.

Janë s’kualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

- I. Bashkimi i operatorëve ekonomik “PC STORE” sh.p.k dhe “RIKON- AL” Sh.p.k**
- II. Operatori ekonomik “Sinteza CO” Sh.p.k**
- III. Operatori ekonomik “Adenis Kastrati”**

1. Bashkimi i operatorëve ekonomik “PC STORE” sh.p.k dhe “RIKON- AL” Sh.p.k NUIS L01606034A dhe NUIS L22119010H

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme;

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky bashkim operatorësh ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

I.1 Bashkimi i operatorëve ekonomikë “PC STORE” sh.p.k dhe “RIKON- AL” sh.p.k, ka paraqitur Akt Marrëveshjen (kontratë bashkëpunimi) me nr. Repertori 9026, datë 15.06.2021 dhe nr. Koleksioni 3362. Lidhur me bashkimin e operatorëve ekonomik, Neni 74 “Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë” i VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar) parashikon:

*“1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. **Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi**”.*

*2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit **dhe elementet konkrete**, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen nëbashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.*

*3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP **dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit**. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.*

Referuar sa më sipër, bashkimi i operatorëve ekonomikë ka ndarë përqindjen e pjesëmarrjes, por nuk ka përcaktuar të gjithë elementët konkretë të projektit si dhe dokumentacioni i paraqitur për këtë procedurë rezulton se nuk është në përputhje me ato element që ka marrë përsipër secili OE.

Konkretisht:

Nr. “RIKON- AL” sh.p.k 60 % (Elementët konkretë në marrëveshje)

- 1** *Do të angazhohet për garantimin, disponimin e sasisë së pajisjeve të kërkuara sipas sasive të kontratës.*

- 2 Do të angazhohet për garantimin e 2 (dy) specialistë të certifikuar për Pajisje A3 bardhë e zi e madhe të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.
- 3 Do të angazhohet për garantimin e 2 (dy) specialistë të certifikuar për Pajisje A3 bardhë e zi e vogël të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.
- 4 Do të angazhohet për garantimin e transportit sipas kontratës.
- 5 Do të angazhohet për garantimin e mirëmbajtjes së pajisjeve.
- 6 Do të angazhohet për garantimin e instalim konfigurimit të softit e pajisjeve.
- 7 Do të angazhohet për c'instalimin e pajisjeve dhe transportin e tyre në magazinë pas përfundimit të objektit të kontratës.
- 8 Do të angazhohet 4 inxhinierë për garantimin e ekzekutimit të kënaqshëm të kontratës.
- 9 Do të vendosë në dispozicion të garantimit të ekzekutimit të kontratës në mënyrë eficiente dhe të shpejtë 4 automjete.
- 10 Do të angazhohet për garantimin e furnizimit me tonera për pajisjet objekt kontrate.

Nr. PC STORE sh.p.k 40 % (Elementët konkretë në marrëveshje)

- 1 Do të angazhohet për garantimin e 1 (një) specialist të certifikuar si Project Manager ose ekuivalente për menaxhimin e projektit.
- 2 Do të angazhohet për garantimin e 1 (një) specialist të certifikuar në nivel Associate për Routing dhe Sëitching ose ekuivalent për konfigurimet e nevojshme në rrjetin ekzistues për implementimin e zgjidhjes softëare dhe të pajisjeve të kërkuara.
- 3 Do të angazhohet për garantimin e 1 (një) specialist të certifikuar për pajisje Printer Barcode të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.
- 4 Do të angazhohet 1 (një) specialist të certifikuar në nivel MCSA për Eëindoës Server ose ekuivalent për të gjithë konfigurimet e nevojshme të sistemit softëare në infrastrukturën përkatëse dhe AD.
- 5 Do të angazhohet 1 (një) specialist të certifikuar në nivel MCSE për Infrastrukturë ose ekuivalent për të gjithë konfigurimet e nevojshme në infrastrukturën e serverave.
- 6 Do të angazhohet për garantimin e realizimit me sukses dhe suportit të krijimit të infrastrukturës së rrjetit, instalimin konfigurimit e pajisjeve.
- 7 Do të angazhohet 4 inxhinierë me qëllim përmbushjen sa më efektive të kontratës.
- 8 Do të angazhohet për garantimin e komunikimit të rrjetit sipas specifikimeve teknike të kërkuara dhe standardeve ndërkombëtare të cilësisë ISO 27001.
- 9 Do të angazhohet për garantimin e serverit për instalimin e softëare.
- 10 Do të angazhohet për garantimin e furnizimit me letër për pajisjet objekt kontrate.
- 11 Do të angazhohet me inxhinierët e vetë me qëllim mbështetjen e operatorit "RIKON-AL" shpk për realizimin me sukses të angazhimeve të veta për instalimin, konfigurimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve.
- 12 Do të vendosë në dispozicion të garantimit të ekzekutimit të kontratës në mënyrë eficiente dhe të shpejtë 4 automjete.

Sikurse evidentohet sa më sipër, në marrëveshje nuk është përcaktuar se cili nga operatorët ekonomikë do të garantojë elementët konkretë të përcaktuar në dst si më poshtë:

- e. Të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar për Pajisje A3 Me Ngjyra për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.
- f. Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për Pajisje A4 Printer të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.

KVO gjykon se marrëveshja e paraqitur nga BOE nuk përmbush kërkesat e parashikuara në Nenin 74 të VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) si më sipër nënvizuar.

I.2 Kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.7 “ Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizimin e Prodhuesit ose distributorit të autorizuar për rajonin e Shqipërisë për të gjitha pajisjet dhe komponentin softëare të ofertuara, për këtë procedurë prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, email, ëbsite, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi. ”

Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit të operatorëve ekonomikë, neni 5 pika 5.3“Shoqëria RIKON-AL” shpk, për angazhimet e së cilës nevojiten certifikimet sipas ISO 9001, do të kryejë shërbimet dhe angazhimet si më poshtë: 2-Do të angazhohet **për garantimin, disponimin e sasisë së pajisjeve të kërkuara sipas sasive të kontratë**”

Referuar ndarjes së elementëve konkrete (ato që janë parashikuar në marrëveshje) nga BOE rezulton se OE “RIKON- AL” sh.p.k ka marrë përsipër garantimin dhe disponimin e pajisjeve të kërkuara sipas sasive të kontratës (me përjashtim të serverit që do të ofrohet nga OE “PC STORE” sh.p.k). Ndërkohë në dokumentat e tenderit BOE ka paraqitur paraqitur Autorizim Prodhuesi ose distributori të autorizuar konbcretisht si më poshtë vijon.

Pajisjet e kërkuara nga AK në dst	Modelet e ofertuara sipas dokumentit të ofertës teknike “Specifikime BO_PC_STORE_RIKON”	Operatori ekonomik, pjesë e BOE për të cilin janë paraqitur Autorizimet e prodhuesit ose distributorit të autorizuar
Pajisje A3 Bardhë e Zi e madhe	RICOH MP 3554	“RIKON- AL” sh.p.k
Pajisje A3 Bardhë e Zi e vogël	RICOH MP3054	“RIKON- AL” sh.p.k
Pajisje A3 me ngjyra	RICOH C3500	“RIKON- AL” sh.p.k
Pajisje A4 Printer	RICOH P800	“RIKON- AL” sh.p.k
Pajisje Printer Barcode	ZEBRA ZT600	PC Store (duhet të paraqitej autorizim për Rikon)
Pajisje A0	HP Design Jet XL3600	Mungon (duhet të paraqitej autorizim për OE “RIKON- AL” sh.p.k
Skaner Profesional	EPSON Ęork Force DS-870	PC Store (duhet të paraqitej autorizim për “RIKON- AL” sh.p.k)
Softëare	RICOH Device Manager NX Pro+ NX Enterproce+ NXV3 + Equitrac	“RIKON- AL” sh.p.k

Print Server HPE HPE ProLian DL360 Gen 10 PC Store
ProLian DL 360 Gen Server
10 Server

Për sa më sipër, rezulton se “RIKON- AL” sh.p.k bazuar në kontratën e bashkëpunimit të paraqitur në spe për këtë procedurë prokurimi ka marrë përsipër disponimin e pajisjeve, ndërkohë që autorizimet përkatëse për pajisjet Printer Barcode dhe Skaner Profesional nuk janë për operatorin ekonomik “RIKON- AL” sh.p.k, por për operatorin ekonomik “PC STORE” sh.p.k. Ndërkohë, “PC STORE” sh.p.k, referuar detyrimeve të marra përsipër në marrëveshjen e bashkëpunimit, mundëson garantimin vetëm për Print Server dhe jo për pajisjet e tjera objekt kontrate. Për sa kohë, OE “PC STORE” sh.p.k nuk ka marrë përsipër furnizimin me këto pajisje (Printer Barcode dhe Skaner Profesional) autorizimet e paraqitura nuk konsiderohen të vlefshme sipas kërkesave të kriterit 2.3.7 të dst. KVO në vijim të arsyetimit mbi dokumentacionin e paraqitur në funksion të përmbushjes së këtij kriteri konstaton gjithashtu se dokumenti i paraqitur “Epson European Distribution Agreement 2009”, nuk rezulton të jetë përkthyer i plotë (dokumenti në gjuhën angleze 9 faqe dhe dokumenti i përkthyer në gjuhën shqipe 3 faqe). Për më tepër në dokumentin origjinal (anglisht) dhe atë të përkthyer mungon Aneksi 1 (sikurse është emërtuar në dokument, pika 12.10 e versionit origjinal të marrëveshjes) i cili sikurse citohet në këtë pikë përcakton kategorinë e produkteve (“*product category*”) për të cilat distributori autorizohet nga prodhuesi, c’ka nuk garanton nëse ITD është i autorizuar nga prodhuesi për distribucionin e produkteve të ofertuara nga BOE për zërin “Skaner Profesional” .

Gjithashtu në vijim të arsyetimit mbi plotësimin e këtij kriteri në tërësi, konstatohet se BOE ka paraqitur DAF ” ... për shitje të produkteve të markës, Heëlett Packard Enterprise...” dhe në lidhje me këtë dokument sqarohet:

- Nga kërkimet që bëjmë në faqen zyrtare të produkteve HP ENTERPRISE, www.hpe.com, na rezulton se ofrohen vetëm produkte si server, pajisje rrjeti, storage. Pra ky autorizim i paraqitur nuk është i vlefshëm për pajisje si printera, fotokopje...sikurse është tipologjia e pajisjes **HP Design Jet XL3600** e ofertuar për zërin “Pajisje A0” . Pra, për këtë të fundit do të ishte i vlefshëm autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar për produkte të markës HP (në faqen zyrtare përkatëse www.hp.com të së cilës rezulton të ofrohen produkte si printera, PC, laptop...). Në faqen zyrtare të HPE rezulton se prej vitit 2015 Heëlett Packard Enterprise është ndarë nga Heëlett Packard Company <https://ëëë.hpe.com/us/en/neësroom/press-release/2017/03/heëlett-packard-enterprise-launches-as-enterprise-technology-leader-ëith-53-billion-in-annual-revenue.html>)
- Nga ana tjetër, për cdo rast autorizimi i paraqitur duhet të ishte adresuar për operatorin ekonomik “RIKON- AL” sh.p.k i cili ka marrë përsipër garantimin e pajisjes.

Pra, për sa më sipër, kriteri për zërin “Pajisje A0” nuk përmbushet sipas kërkesave të pikës 2.3.7 të dst.

Për sa më sipër KVO konkludon se BOE nuk e ka përmbushur kriterin 2.3.7 të kapacitetit teknik, si pjesë e kritereve të vecanta të kualifikimit.

I.3 BOE “PC STORE” sh.p.k dhe “RIKON- AL” Sh.p.k sipas zërave/përqindjes që ka marrë përsipër referuar marrëveshjes së bashkëpunimit, nuk plotëson kërkesat e parashikuara në Dokumentat Standarde të Tenderit, sipas pikave më poshtë:

1. *“2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me standartin ISO 9001, për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).
Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes”.*

Operatori ekonomik “PC STORE” sh.p.k nuk ka paraqitur Certifikatën ISO 9001 sipas përcaktimeve të këtij kriteri.

2. *“2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me standartin ISO 20000 për sistemin e menaxhimit të shërbimit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).
Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.”*

Operatori ekonomik “PC STORE” sh.p.k nuk ka paraqitur Certifikatën ISO 20000 sipas përcaktimeve të këtij kriteri.

3. *“2.3.4 Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me standartin ISO 27001 për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).
Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.”*

Operatori ekonomik “PC STORE” sh.p.k nuk ka paraqitur Certifikatën ISO 27001 sipas përcaktimeve të këtij kriteri.

Sa më sipër, BOE nuk i ka përmbushur kriteret 2.3.2, 2.3.3, 2.3.4 të kapacitetit teknik, si pjesë e kriterëve të vecanta të kualifikimit.

I.4 Lidhur me kriterin e përcaktuar në pikën “2.3.6 (f) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për Pajisje Printer Barcode të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjen përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit”, KVO konstaton:

Në marrëveshjen e bashkëpunimit, është përcaktuar se shoqëria “PC STORE” sh.p.k. do të garantojë specialistin e certifikuar për printer barcode të ofertuar. Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se të dy certifikatat për “Pajisje Printer Barcode ZEBRA ZT600”, të paraqitura nga z. L.B, konkretisht “ADC Key Technical Concepts” dhe “Advanced Data Capture

Portfolio”, janë certifikata mbi pajisjet e skanimit, që përfshijnë: konfigurimin, dizenjimin, suportin e pajisjeve të skanimit. Sa më sipër, nuk garantohej dhe plotësohet kërkesa për 1 (një) specialist të certifikuar për Pajisje Printer Barcode të ofertuar.

Sa më sipër, BOE nuk e ka përmbushur kriterin 2.3.6 (f) të kapacitetit teknik, si pjesë e kriterëve të vecanta të kualifikimit.

I.5 Lidhur me kriterin e përcaktuar në pikën “2.3.8 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 6 mjete transporti për shpërndarjen e pajisjeve, implementimin në kohë dhe mundësinë e lëvizjes së specialistëve për të dhene shërbimin ne kohe në të gjithë vendndodhjet ku ushtron aktivitetin Bashkia Tiranë. Për vërtetimin e disponueshmërisë se mjeteve OE duhet të paraqesë“:

4. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikatë pronësie, plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (të vlefshme) si dhe duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të shërbimit objekt i këtij prokurimi. Për mjetet që nuk regjistrohen në regjistrat publik duhet të paraqiten kontrata shitblerje/fatura tatimore/dokumentat e zhdoganimit të paisjeve.” KVO gjykon:

Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit të operatorëve ekonomikë të paraqitur për këtë procedurë prokurimi, neni 5, pika 5.3 (13) përcaktohet se shoqëria “PC Store” sh.p.k.... “do të vendosë në dispozicion të garantimit të ekzekutimit të kontratës në mënyrë eficiente dhe të shpejtë 4 automjete.” Po në pikën 5.3 të këtij neni, shoqëria “RIKON-AL” sh.p.k në pikën 10 merr përsipër.. “të vendosë në dispozicion të garantimit të ekzekutimit të kontratës në mënyrë eficiente dhe të shpejtë 4 automjete”. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur, rezulton se:

“PC Store” sh.p.k ka paraqitur dokumentacionin për 4 automjete të cilat kanë mangësi në dokumentacion respektivisht si më poshtë:

- a. Mjeti me targa AB 461 CM – Certifikata e pronësisë së mjetit, nuk përmban elementët ligjore të një dokumenti zyrtar të lëshuar nga institucione shtetërore sipas legjislacionit në fuqi, pasi është dokument pa nënshkrim dhe pa vulë.
- b. Mjeti me targa AA 254 OK -Certifikata e pronësisë së mjetit, nuk përmban elementët ligjore të një dokumenti zyrtar të lëshuar nga institucione shtetërore sipas legjislacionit në fuqi, pasi është dokument pa nënshkrim dhe pa vulë.
- c. Mjeti me targa AA 139 IZ. Certifikata e pronësisë së mjetit, nuk përmban elementët ligjore të një dokumenti zyrtar të lëshuar nga institucione shtetërore sipas legjislacionit në fuqi, pasi është dokument pa nënshkrim dhe pa vulë.
- d. Mjeti me targa AA 730 KL – Certifikata e pronësisë së mjetit, nuk përmban elementët ligjore të një dokumenti zyrtar të lëshuar nga institucione shtetërore sipas legjislacionit në fuqi, pasi është dokument pa nënshkrim dhe pa vulë.

“RIKON-AL” sh.p.k ka paraqitur dokumentacionin për 5 automjete të cilat kanë mangësi në dokumentacion respektivisht si më poshtë:

- a. Mjeti me targa AA 795 GI - Nuk është paraqitur certifikata e pronësisë së mjetit.
- b. Mjeti me targa AB 994 DJ –Nuk është paraqitur Leja e Qarkullimit dhe Siguracioni i Mjetit.
- e. Mjeti me targa AA 755 XI - Certifikata e pronësisë së mjetit, nuk përmban elementët ligjore të një dokumenti zyrtar të lëshuar nga institucione shtetërore sipas legjislacionit në fuqi, pasi është dokument pa nënshkrim dhe pa vulë.

Sa më sipër, BOE nuk e ka përmbushur kriterin 2.3.8 të kapacitetit teknik, si pjesë e kriterëve të vecanta të kualifikimit.

I.6 Lidhur me kriterin “2.3.9 Operatori ekonomik duhet të ketë gjendje në magazinë (në stok) minimalisht 45% e sasisë së pajisjeve të ofertuara për të garantuar implementimin dhe garantimin e vijueshmërisë së shërbimit brenda kushteve dhe afateve të kërkuara. Për vërtetimin e këtij kriteri duhet të paraqiten faturat e blerjes/deklaratë doganore ku të jenë detajuar modelet dhe numrat serial të pajisjeve. Autoriteti Kontraktor mund të kryejë verifikim në magazinat e operatorëve ekonomik për të vlerësuar nëse ky kriter është plotësuar.” KVO arsyeton:

Për vërtetimin e këtij kriteri duhet të paraqiten faturat e blerjes/deklaratë doganore ku të jenë detajuar modelet dhe numrat serial të pajisjeve. Nga verifikimi i dokumentacionit mbi përmbushjen e këtij kriteri, rezulton se shoqëria “RIKON-AL” sh.p.k ka paraqitur 7 fatura (invoice) si më poshtë:

1. Fatura e datës 23.10.2019
2. Fatura nr. 00340/20, e datës 25.09.2020
3. Fatura nr. 00115/21, e datës 01.02.2021
4. Fatura nr. 4/20, e datës 17.10.2020
5. Fatura nr. 3/20, e datës 22.07.2020
6. Fatura nr. 19/211, e datës 30.04.2019
7. Fatura nr. 00306/20, e datës 22.07.2020

5. 5 prej faturave të mësipërme (1, 2, 3, 6, 7) nuk janë në gjuhën shqipe dhe nuk janë shoqëruar me përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe duke rënë në kundërshtim me përcaktimin e bërë në nenin 14 pika 2 e VKM nr 914 dt 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) ku është përcaktuar se: ...“Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe”...
6. 5 prej faturave të paraqitura (1, 2, 3, 6, 7) nuk përmbajnë numrat serial të pajisjeve sikurse është cituar në kërkesat e kriterit të mësipërm.

Gjithashtu këto janë fatura nga furnitorë të huaj për të cilat nuk janë paraqitur deklarata doganore për të provuar se ky mall është futur në territorin e Shqipërisë konform legjislacionit në fuqi, pra nuk vërtetohet se OE i disponon gjendje këto pajisje.

Por c’ka është më e rëndësishme, nga verifikimet e pajisjeve të dokumentuara me faturat e paraqitura në spe edhe në rast se ato do të ishin të rregullta, rezulton se nuk përmbushet sasia prej 45 % e pajisjeve të kërkuara (87 pajisje) sipas modelit të ofertuar në dokumentin e ofertës teknike të BOE.

Sa më sipër KVO konkludon se BOE nuk e ka përmbushur kriterin 2.3.9 të kapacitetit teknik, si pjesë e kritereve të vecanta të kualifikimit.

I.7 Lidhur me kriterin “2.3.10 Operatori ekonomik duhet që të paraqesë ofertën teknike ku:

- a. Të përcaktohen marka dhe modeli për pajisjet dhe softëare që propozon/oferton.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë gjithashtu, katalogë ose broshurë për mallin dhe softëare që propozon. Katalogu ose broshura duhet të ketë të detajuar specifikimet teknike të produktit të propozuar. Në katalog duhet të markohet me ngjyrë pajisja që ofrohet dhe të pasqyrohet përputhshmëria e specifikimeve teknike të kërkuara për këto pajisje. Fleta ose fletët e katalogut/broshurës që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjes dhe të softëare duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuara.” KVO konstaton.:

U verifikuan modelet e ofertuara nga bashkimi operatorëve ekonomik për secilin zë me informacion të detajuar mbi markën, modelin, si dhe katalogun/broshurën përkatëse për mallin që oferton nga ku rezulton si më poshtë:

1. Për zërin **Pajisje A3 Bardh e zi e madhe është ofertuar pajisja “Ricoh MP 3554”**.

Nga verifikimi i katalogut/ broshurës për pajisjen e ofertuar për këtë zë referuar ofertës teknike të paraqitur, rezulton se nuk plotësohen karakteristikat minimale teknike konkretisht si më poshtë:

- Karakteristika minimale teknike të kërkuara për “Kapaciteti në dalje”- **300 faqe, deri në 3000.**
Pajisja e ofertuar për këtë karakteristikë disponon- **500 faqe deri në 1625 max.**
- Karakteristika minimale teknike të kërkuara për “Hard Disk”- **350 GB.**
Pajisja e ofertuar për këtë karakteristikë disponon **320 GB.**
- Karakteristika minimale teknike të kërkuara për “Skanimi-n” - Të mundësohet skanimi në FTP - **Scan to FTP.**
Pajisja e ofertuar për këtë karakteristikë nuk disponon **skanimin në FTP.**
- Karakteristika minimale teknike të kërkuara për “ARDF”- **140 faqe.**
Pajisja e ofertuar për këtë karakteristikë disponon **100 faqe në ARDF.**

2. Për zërin **Pajisje A3 Bardh e zi e Vogël është ofertuar pajisja “Ricoh MP3054”**.

Nga verifikimi i katalogut/ broshurës për pajisjen e ofertuar për këtë zë referuar ofertës teknike të paraqitur, rezulton se nuk plotësohen karakteristikat minimale teknike konkretisht si më poshtë:

- Karakteristika minimale teknike të kërkuara për “Resolucioni Print”- **1800 x 600 dpi.**
Pajisja e ofertuar për këtë karakteristikë disponon- **1200 x 1200 dpi.**

- Karakteristika minimale teknike të kërkuara për “*Skanimi-n*” - Të mundësohet skanimi në FTP - **Scan to FTP**.
Pajisja e ofertuar për këtë karakteristikë nuk disponon **skanimin në FTP**.

3. Për zërin **Pajisje A3 Me Ngjyra është ofertuar pajisja “Ricoh C3500”**

Nga verifikimi i katalogut/ broshurës për pajisjen e ofertuar për këtë zë referuar ofertës teknike të paraqitur, rezulton se nuk plotësohen karakteristikat minimale teknike konkretisht si më poshtë:

- Karakteristika minimale teknike të kërkuara për “*Resolucioni Print*”- **2400 x 1200 dpi**.
Pajisja e ofertuar për këtë karakteristikë disponon- **1200 x 1200 dpi**.
- Karakteristika minimale teknike të kërkuara për “*Kapaciteti në dalje*”- **400 faqe, deri në 3000**.
Pajisja e ofertuar për këtë karakteristikë disponon- **500 faqe deri në 1625 max**.
- Karakteristika minimale teknike të kërkuara për “*Skanimi-n*” - **Scan to FTP**.
Pajisja e ofertuar për këtë karakteristikë nuk disponon **skanimin në FTP**.
- Karakteristika minimale teknike të kërkuara për “*ARDF*”- **300 faqe**.
Pajisja e ofertuar për këtë karakteristikë disponon **100 faqe në ARDF** sikurse është nënvizuar në katalogun e kësaj pajisje.

4. Për zërin **A4 Printer është ofertuar pajisja “Ricoh P 800”**

Nga verifikimi i katalogut/ broshurës për pajisjen e ofertuar për këtë zë referuar ofertës teknike të paraqitur, rezulton se nuk plotësohen karakteristikat minimale teknike konkretisht si më poshtë:

- Karakteristika minimale teknike të kërkuara për “*Volumin Mujor*”- **250,000 faqe**.
Për pajisjen e ofertuar, nuk vërtetohet kjo karakteristikë në katalogun e paraqitur.
Nga verifikimet në faqen zyrtare të prodhuesit rezulton se numri i volumit mujor është – **16,600 faqe**.

5. Për zërin **Pajisje Printer Barcode është ofertuar pajisja “Zebra ZT600”**

Nga verifikimi i katalogut/ broshurës për pajisjen e ofertuar për këtë zë referuar ofertës teknike të paraqitur, rezulton se nuk plotësohen karakteristikat minimale teknike konkretisht si më poshtë:

- Karakteristika minimale teknike të kërkuara për “*Gjatësia Ribonit*” - **≥800 m**.
Pajisja “*Zebra ZT600*” e ofertuar ka karakteristikën “*Gjatësia Ribonit*” - **450 m**.

6. Për zërin **Pajisje A0 është ofertuar pajisja “HP DesignJet XL 3600”**

Nga verifikimi i katalogut/ broshurës për pajisjen e ofertuar për këtë zë referuar ofertës teknike të paraqitur, rezulton se nuk plotësohen karakteristikat minimale teknike konkretisht si më poshtë:

- Është kërkuar media ëdth 8"-36", ndërkohë pajisja e ofertuar suporton 11"-36". Gjithashtu në katalogun e paraqitur nuk specifikohen qartë edhe specifikime të tilla Nozzle Number, Nozzle Pitch etj.

Referuar sa më sipër, pajisjet e ofertuara nga ky bashkim operatorësh ekonomik nuk plotëson "Karakteristikat Minimale Teknike", pasi nuk përmbush specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor për zërat e sipërcituar për këtë procedurë prokurimi.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar dhe mbështetje të Kreut VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Operatori ekonomik Sinteza CO shpk NUIS K11324003F

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme;

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar) dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky operator ekonomik, nga ku rezultoi se nuk janë përmbushur kriteret e përcaktuara në Dokumentat Standarde të Tenderit, si më poshtë:

- Kriteri 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 3: Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2021 sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" (i ndryshuar). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB).

Operatori Ekonomik ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore vetëm për vitin 2020 dhe jo për vitin 2021.

- Kriteri 2.3 Kapaciteti teknik: pika 2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, me një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet ose 24.913.112 (njëzet e katër milion e nëntëqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e dymbëdhjetë) lekë pa tvsh dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. *Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:*

b. Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me sektorin privat, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat përkatëse të shitjes të nënshkruara nga të dyja palët (ku të shprehen qartë datat, shumat dhe shërbimet e realizuara).

OE ka paraqitur faturat e shërbimit të realizuara me sektorin privat, por që në tërësi nuk përmbushin 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet ose 24.913.112 (njëzet e katër milion e nëntëqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e dymbëdhjetë) lekë pa tvsh, pasi shuma e këtyre faturave për shërbime të ngjashme, është 2.450.986 (dy milion e katërqind e pesëdhjetë mijë e nëntë qind e tetëdhjetë e gjashtë lekë) pa tvsh.

Sa më sipër, OE nuk e ka përmbushur kriterin 2.3.1 të kapacitetit teknik, si pjesë e kriterëve të vecanta të kualifikimit.

- Kriteri 2.3.5: Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 5 (pesë) inxhinierë në informatikë, elektrike, elektronike, fizikë, teknologji informacioni, ose mekatronik që do të ndjekin zbatimin e kontratës.

Për të vërtetuar këtë operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Deklaratë të Operatorit Ekonomik për stafin përgjegjës
- Diplomë për inxhinierët e kërkuar.
- Listëpagesat sipas formularit E-Sig 025/a për 3 muajt e fundit të deklaruara sipas legjislacionit në fuqi.

OE nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për përmbushjen e këtij kriteri.

- Kriteri 2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se ka stafin e nevojshëm teknik të kualifikuar për implementimin dhe për suportin përgjatë gjithë kohëzgjatjes së shërbimit. Punonjësit duhet të jenë të pajisur me certifikata nga prodhuesi i pajisjeve të ofertuara për të vërtetuar aftësinë e tyre për implementim, konfigurime të komponentit softëare të kërkuar, përmbushjen e termave të SLA si dhe garantimin e vijueshmërisë së shërbimit, si më poshtë:....

OE nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për përmbushjen e këtij kriteri.

- Kriteri 2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizimin e Prodhuesit ose distributorit të autorizuar për rajonin e Shqipërisë për të gjitha pajisjet dhe komponentin softëare të ofertuara, për këtë procedurë prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, email, ëbsite, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi.

OE nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për përmbushjen e këtij kriteri.

- Kriteri 2.3.8 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 6 mjete transporti për shpërndarjen e pajisjeve, implementimin në kohë dhe mundësinë e lëvizjes së specialistëve për të dhene shërbimin në kohe në të gjithë vendndodhjet ku ushtron aktivitetin Bashkia Tiranë. Për vërtetimin e disponueshmërisë së mjeteve OE duhet të paraqesë:....

OE nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për përmbushjen e këtij kriteri.

- Kriteri 2.3.9 Operatori ekonomik duhet të ketë gjendje në magazinë (në stok) minimalisht 45% e sasisë së pajisjeve të ofertuara për të garantuar implementimin dhe garantimin e vijueshmërisë së shërbimit brenda kushteve dhe afateve të kërkuara. Për vërtetimin e këtij kriteri duhet të paraqiten faturat e blerjes/deklaratë doganore ku të jenë detajuar modelet dhe numrat serial të pajisjeve. Autoriteti Kontraktor mund të kryejë verifikim në magazinat e operatorëve ekonomik për të vlerësuar nëse ky kriter është plotësuar.

OE nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për përmbushjen e këtij kriteri.

- Kriteri 2.3.10 Operatori ekonomik duhet që të paraqesë ofertën teknike ku:
 - Të përcaktohen marka dhe modeli për pajisjet dhe softëare që propozon/oferton
 - a. Operatori ekonomik duhet të paraqesë gjithashtu, katalogë ose broshurë për mallin dhe softëare që propozon. Katalogu ose broshura duhet të ketë të detajuar specifikimet teknike të produktit të propozuar. Në katalog duhet të markohet me ngjyrë pajisja që ofrohet dhe të pasqyrohet përputhshmëria e specifikimeve teknike të kërkuara për këto pajisje. Fleta ose fletët e katalogut/broshurës që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjes dhe të softëare duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuara.
 - b. Operatori ekonomik duhet të faktojë teknikisht si do arrijë të përmbushë kriteret e shërbimit të suportit. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një plan monitorimi dhe zgjidhje të problematikave dhe si do mundësohet ofrimi i shërbimit brenda kohës së kërkuar. Ofertuesi duhet të paraqesë në një printscreen të faqes së internetit ku të demonstron sistemin helpdesk dhe suportit dhe një account test (username dhe password) i cili duhet të vihet në dispozicion për të menaxhuar problematikat e mundshme të përdoruesve.

OE nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për përmbushjen e këtij kriteri.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreut VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3. Operatori ekonomik “Adenis Kastrati” NUIS L51611004I

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Operatori Ekonomik “Adenis Kastrati” nuk plotëson kërkesën sipas pikës 2.1.a) të Dokumentave Standarde të Tenderit, pasi nuk ka paraqitur formularin e ofertës ekonomike për shërbimin objekt prokurimi, sipas Shtojcës 1 të DST:

Referuar faktit se OE “Adenis Kastrati” nuk plotëson një nga kërkesat bazë të DST sikurse është ai i formularit të ofertës, pra ndodhur para faktit që nuk kemi një ofertë ekonomike për procedurën e prokurimit, në vijim të arsyetimit gjykojmë se gjendja faktike dhe juridike e Operatori Ekonomik “Adenis Kastrati” nuk do të ndryshojë duke u s’kualifikuar nga procedura në fjalë, në mbështetje të nenit 55 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik” (i ndryshuar).

Rjedhimisht, kriteret e tjera të përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim, të paraqitura nga OE, nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Në zbatim të nenit 55 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik” (i ndryshuar) përcaktohet:

Oferta fituese duhet të jetë:

a) oferta që, në bazë të kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, plotëson kërkesat e objektit të prokurimit me çmimin më të ulët; ose

b) oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kriteret e ndryshme të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet, si: cilësia, çmimi, cilësitë teknike, karakteristikat estetike, funksionale, mjedisore, kostot e funksionimit, efektshmëria ekonomike, shërbimi pas shitjes dhe asistenca teknike, data dhe periudha e lëvrimit ose periudha e ekzekutimit, me kusht që këto kriteret të jenë objektive dhe jodiskriminuese.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se është identifikuar si operator ekonomik i suksesshëm:

1. Operatori ekonomik «BNT Electronics» sh.p.k me NUIS J61817047D

Çmimi total i ofertës pa TVSH= 61.875.986,40 (gjashtëdhjetë e një milion e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë presje dyzet) lekë .

Rjedhimisht, jeni të lutur të paraqiteni pranë *Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë*, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 14.07.2021.

Ankesa: ka ose jo: Nuk është paraqitur asnje ankesë me shkrim nga operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi.